



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 20.9.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Daut Haradinaj, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarët nga Ministria e Bujqësisë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.9.2011,**
3. **Shqyrtimi i amendamenteve për duhanin,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Nait Hasani-kryetar njoftoi komisionin shkurtimisht për seminarin e djeshëm në Mitrovicë rreth mbeturinave industriale në Trepçë ku është potencuar kërkesa për një ligj të veçantë për këto mbeturina, ndërsa Rendi i ditës u miratua pa ndryshime. **Liburn Aliu** sugjeroi që komisioni në pikën të ndryshme të diskutoi për Hoçën, ndërsa puna e rregullt të vazhdoi në GP rreth këtij projektligji, Komisioni u pajtua.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.9.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.9.2011 me përmirësime nga **Nijazi Idrizi** i cili ka përmendur cifrën 500 milion e jo 500.000 euro, ndërsa **Sevdije Lama** e cila është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë (jo Komunave) rreth djerrinave në Gjakovë.

3. Shqyrtimi i amendamenteve për Projektligjin e duhanit

Nait Hasani-kryetar njoftoi komisionin për obligimet nga takimi i fundit i GP ku është obliguar MB të sjellë sugjerime konkrete për propozimet e **Sevdije Lamës** rreth projektligjit në fjalë, ndaj komisioni u pajtua dhe miratoi amendamentet për këtë projektligj si në vijim :

Amendamenti 1

Neni 3, pas pikës 1.10 shtohet si vijon :

1.11. Furra- vendi ku bëhet terja e duhanit Virxhinja.

Amendamenti 2

Neni 8,

Paragrafi 1, në reshtin e pestë, pas fjalës “llojin” shtohet presja dhe fjala “**klasën**”.

Paragrafi 3 në reshtin e parë pas fjalës “tipet” shtohet “**dhe klasën**”.

Paragrafi 4 në fillim para fjalës së parë shtohet “**Tipin, llojin, klasën dhe**” vazhdon me “kriteret...”.

Amendamenti 3

Neni 18, në paragrafin 2 në reshtin e parë “**është i dënuar**” bëhet “**dënohet**”, ndërsa në reshtin e 4 pas fjalës “ndalon” shtohet “**përherë**”.

Amendamentet do të përcjellën komisioneve të përhershme dhe kryesore në procedim të mëtejshëm.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani në këtë pikë hapi diskutimin rreth Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe pasi që ka nevojë të sqarohen gjërat para se të vazhdoi GP punën rreth këtij Projektligji. Ai njoftoi se Qeveria ka dërguar disa amendamente për të përmirësuar nenet ekzistuese 4,5,7 dhe 9.

Liburn Aliu kryesues i GP, tha se kur është shqyrtuar për herë të parë Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe, nuk e ka pas hartën dhe listën e monumenteve. Ndërsa me kërkesën e grupit punues Ministria e ka sjellë hartën ndërsa listën e monumenteve akoma jo. Me ardhjen e këtyre dy dokumenteve tash kemi një situatë të re, sepse kanë dalë disa informata shpesh që nuk janë ditur në kohën e shqyrtimit të parë. Prandaj duhet kërkuar nga kryesia e kuvendit që ky ligj të kthehet edhe njëherë në ripunim.

Komiteti me përfaqësuesin e kishës ortodokse brenda, nuk mundet me qenë vendimmarrës brenda territorit të republikës së Kosovës për shkak se ne me kushtetute jemi shtet laik. Komuna e Rahovecit e ka planin zhvillimor komunal, krejt në rregull është kur të hartohet ky plan, që fshati Hoçë e Madhe të dërgoj përfaqësuesin e vet me qëllim të mbrojtjes së interesave të veta, mirëpo nuk duhet të jepet kompetencë e veçantë, ashtu siç parashihet me këtë Projektligj.

KZM- nuk mund të jetë autoritet mbi zonën kadastrale dhe në lidhje me planifikimin rural, pasi që është kompetent vetëm për trashëgimi. Në KZM, nuk ka ekspertë të zhvillimit rural. KZM mund të jetë autoritet vetëm mbi ZM-të, përfundoi ai.

Nait Hasani përkujtoi në lidhje me dërgimin e amendamenteve nga qeveria, pikën 3 të nenit 57 të rregullores së kuvendit “*amendamente në projektligj mund të parashirojë deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe qeveria, në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim...*” dmth se një ditë pas skadimit të këtij afati na kanë ardhë këto amendamente nga qeveria.

Daut Haradinaj gjithashtu vërejti se ky projekt tani flet për një territor më të madh gjeografik përveç tokës që e ka kisha-aty ku është. Ai tha se nuk mundet ky këshillë apo komitet me marr kompetencë më tepër sesa që ka Kryetari i Komunës.

Nait Hasani tha se fshati Hoçë e Madhe sipas këtij projektligji është njësi kadastrale, ndërkaq **Nijazi Idrizi** shtoi se këtu gërshetohen tri dokumente: pakoja e Ahtisarit, Ligji për zonat e veçanta dhe Ligji për plotësim ndryshim të ligjit për planifikim hapësinor dt. 10.11.2008 .

Liburn Aliu tha se harta e dërguar nga MMPH dhe lista e monumenteve që duhet të dërgohet, ndërrojnë situatën rreth këtij projektligji dhe për këtë do të diskutohet në takimet e radhës në grupin punues.

Nait Hasani falënderoj dhe caktoi takimet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani